



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 143

---

Tiranë – E hënë, 10 korrik 2017

---

## PËRMBAJTJA

	Faqe
Udhëzim i ministrit të Financave nr. 16, datë 5.7.2017	6911
Për një shtesë dhe ndryshime në udhëzimin nr. 6, datë 30.1.2015, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar..	

**UDHËZIM****Nr. 16, datë 5.7.2017****PËR NJË SHITESË DHE NDRYSHIME NË  
UDHËZIMIN NR. 6, DATË 30.1.2015, “PËR  
TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR NË  
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË  
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të nenit 159, paragrafi 2 të ligjit nr. 92/2014, datë 24.7.2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, ministri i Financave

**UDHËZON:**

Në udhëzimin nr. 6, datë 30.1.2015, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhet shtesa dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në nenin 36, “Zbatimi i shkallës së TVSH-së”, shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar, për furnizimin e shërbimit të akomodimit në strukturat akomoduese, sipas kategorive të përcaktuara në legjislacionin e fushës së turizmit, është 6 për qind”.

2. Modeli i deklaratës së tatimit mbi vlerën e shtuar, i përcaktuar në nenin 67 të udhëzimit, zëvendësohet me modelin e deklaratës së tatimit mbi vlerën e shtuar sipas këtij udhëzimi.

3. Modeli i librit të shitjeve, i përcaktuar në nenin 68 të udhëzimit, zëvendësohet me modelin e librit të shitjeve sipas këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I FINANCAVE****Helga Vukaj**



**DEKLARATA E TATIMIT MBI  
VLEREN E SHITUAR**

**Numri i Vendosjes se Dokumentit (NVD)**  
(Vetem per perdorim zyrtar)

(2) Periudha tatimore

(1) Numri Serial: \_\_\_\_\_

Numri Identifikues i Personit te Tatueshem (NIPT): (3) \_\_\_\_\_  
 Emri Tregtar i Personit te Tatueshem: (4) \_\_\_\_\_  
 Emri Mbiemri i Personit Fizik: (5) \_\_\_\_\_  
 Adresa: (6) \_\_\_\_\_  
 Qyteti/Komuna/Rrethi: \_\_\_\_\_  
 Numri Telefonit: (7) \_\_\_\_\_

Informacioni i mesiperm (rubrikat 4,5,6,7) duhet te jetë i saktë dhe i azhurnuar

[8] Shënoni 'X' nqs gjatë muajit nuk është bërë asnjë transaksion.

	Vlera e tatueshme	TVSH e llogaritur
<i>TVSH e llogaritur për muajin</i>		
(9) Shitje të përjashtuara	(9)	
(10) Shitje pa TVSH	(10)	
(11) Eksporte mallrash	(11)	
(12) Furnizime me shkallë 0%	(12)	
(13) Shitje të tatueshme (me shkallë 20%)	(13)	(14)
(15) Shitje të tatueshme (me shkallë 6%)	(15)	(16)
(17) Shitje të tatueshme sipas regjimeve të agjentit të ndërtimit/ të marzhit të fitimit/të shitjeve në ankand (20%)	(17)	(18)
(19) Antongarkesë TVSH-së në shitje (reverse charge) (19 x 20%)	(19)	(20)
(21) Borxhi i keq	(21)	(22)
(23) Totali TVSH-së së llogaritur $\{(14)+(16)+(18)+(20)+(22)\}$		(23)

	Vlera e tatueshme	TVSH e zbritshme
<i>TVSH e zbritshme për muajin</i>		
(24) Blerje të përjashtuara, TVSH jo e zbritshme/pa TVSH	(24)	
(25) Blerje investimi brenda vendit pa TVSH	(25)	
(26) Importe te perjashtuara te investimit pa TVSH	(26)	
(27) Import mallra të përjashtuara nga TVSH	(27)	
(28) Import mallra me shkallë tatimore 20%	(28)	(29)
(30) Importe te investimit me TVSH 20%	(30)	(31)
(32) Blerje nga furnitor vendas me shkallë 20%	(32)	(33)
(34) Blerje te Investimit Brenda vendit me TVSH 20%	(34)	(35)
(36) Blerje nga fermerët vendas (20%)	(36)	(37)
(38) Antongarkesë e TVSH-së në blerje me të drejtë kreditimi (reverse charge)	(38)	(39)
(40) Rregullime të TVSH-së së zbritshme	(40)	(41)
(42) Borxhi i keq	(42)	(43)
(44) Totali TVSH-së së zbritshme $\{(29)+(31)+(33)+(35)+(37)+(39)+(41)+(43)\}$		(44)

(45) Teprica e TVSH se zbritshme për muajin $\{(23)-(44)\}$ nqs $\{(23)<(44)\}$	(45)
(46) TVSH I DETYRUESHEM PER TU PAGUAR $\{(23)-(44)\}$ nqs $\{(23)>(44)\}$	(46)

**Data dhe Firma e Personit të Tatueshëm** - Deklaroj nën përgjegjësi time që informacioni i mësipërm është i plotë dhe i saktë.



## Deklaratë për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (DTVSH)

1. **Numri serial** perdoret nga Drejtoria Rajonale Tatimore dhe shërben për të azhurnuar regjistrimet tuaja kur paraqitet deklarata.  
2. **Periudha Tatimore** është muaji i paraqitur nga dita e parë deri në ditën e fundit. Të gjitha transaksionet (Shitjet, Blerjet) dhe llogaritjet mujore të TVSH-së të kryera gjatë kësaj periudhe duhet të përshihen në kete deklarata.

### Të dhëna të Personit të Tatueshëm

3. **Numri Identifikues i Personit të Tatueshëm (NIPT/NUIS)** është numri i vetëm që ju përfaqson dhe identifikon në të gjitha marrëdhëniet me Administratën Tatimore Qendrore. NIPT/NUIS duhet të vendoset detyrimisht në çdo futur që lëshoni ose merrni.  
4. **Emri Tregtar i Personit të Tatueshëm** është emri tregtar me të cilin ju jeni regjistruar në QKR ose Drejtorinë Rajonale Tatimore sipas legjislacionit tatimor në fuqi dhe që tregohet në certifikatën tuaj të regjistrimit si NIPT/NUIS.  
5. **Emri, Mbiemri i Personit Fizik** vendoset kur veprimtaria ekonomike kryhet nga një Person Fizik dhe nuk ka emër tregtar.  
6. **Adresa** tregohet për vendin kryesor të ushtrimit të veprimtarisë tuaj ekonomike. Kjo adresë është e treguar edhe në certifikatën tuaj të NIPT/NUIS.  
7. **Numri i Telefonit** (nqs keni) tregon numrin e telefonit në vendin kryesor të ushtrimit të veprimtarisë tuaj ekonomike.  
8. **Nëqoftëse** ju nuk keni kryer asnjë transaksion gjatë muajit, shënoni një "X" në kutinë 8. Sipas mënyrës së deklarimit, plotësoni datën dhe firmosni duke deklaruar në këtë mënyrë që informacioni i dhënë në deklarata është i plotë dhe i saktë.

### TVSH e llogaritur për muajin

9. Nga kolona "e" -"Shitje të përjashtuara" e librit tuaj të shitjeve nxirri totalin e të gjithë shitjeve të përjashtuara të muajit dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 9 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen shitjet e përjashtuara sipas Kapitullit 8 seksioni 1 të ligjit, për të cilat nuk llogaritet TVSH.

10. Nga kolona "f" -"Shitje pa TVSH" e librit tuaj të shitjeve nxirri totalin e të gjithë shitjeve pa TVSH të muajit dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 10 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen shitjet e paturueshme në Shqipëri për të cilat nuk llogaritet TVSH.

11. Nga kolona "g" -"Eksporte mallrash" të librit tuaj të shitjeve nxirri totalin e të gjithë eksporteve të mallrave me shkallë tatimore 0% të bëra për muajin dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 11 të Deklaratës tuaj. Furnizimet Eksporte sipas nenit 57 të ligjit taten me shkallë 0%

12. Nga kolona "gj" -"Furnizime me shkallë 0%" e librit tuaj të shitjeve nxirri totalin e të gjithë furnizimeve me shkallë tatimore 0% të bëra për muajin dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 10 të Deklaratës tuaj, furnizime sipas Kapitullit 8 Seksioni 3 përveç eksportit të mallrave që deklarohen në kutinë 11.

13. Nga kolona "h" -"Vlera e Tatueshme për shitje me shkallë 20%" nxirri totalin për transaksionet e bëra gjatë muajit të cilat sipas ligjit që i nënshtrohen shkallës tatimore TVSH 20%, dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 13 të Deklaratës tuaj. (vlera +/-)

14. Nga kolona "i" e librit të shitjeve "TVSH për shitje me shkallë 20%", nxirri totalin e tvsh-së për muajin për shitjet me shkallë 20% dhe shumën e përftuar vendoseni në kutinë 14 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 14 duhet të jetë e barabartë me 20% të vlerës së paraqitur në kutinë 13. (vlera +/-)

15. Nga kolona "j" e librit të shitjeve "Vlera e Tatueshme për shitje me shkallë 6%" nxirri totalin për transaksionet e bëra gjatë muajit, të cilat sipas ligjit, i nënshtrohen shkallës tatimore TVSH 6% dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 15 të Deklaratës tuaj. (vlera +/-)

16. Nga kolona "k" e librit të shitjeve "TVSH për shitje me shkallë 6%", nxirri totalin e TVSH-së për muajin për shitjet me shkallë 6% dhe shumën e përftuar vendoseni në kutinë 16 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 16 duhet të jetë e barabartë me 6% të vlerës së paraqitur në kutinë 15. (vlera +/-)

17. Nga kolona "l" e librit të shitjeve "Vlera e Tatueshme për Shitje sipas regjimit të agjentëve të udhëtimit/ marzhi fitimit (shitje në ankand)" nxirri totalin për transaksionet e bëra gjatë muajit dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 17 të Deklaratës tuaj. Këtu shitjet të tatueshme i nënshtrohen shkallës 20% të TVSH-së.

18. Nga kolona "ll" e librit të shitjeve "TVSH për shitje regjimi agjentëve të udhëtimit/ marzhi fitimit (shitje në ankand)", nxirri totalin e TVSH-së të shitjeve për muajin dhe shumën e përftuar vendoseni në kutinë 18 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 18 duhet të jetë e barabartë me 20% të vlerës së paraqitur në kutinë 17.

19. Nga kolona "m" e librit të shitjeve "Vlera e Tatueshme për Autogarkesë TVSH në shitje" nxirri totalin për transaksionet për të cilat llogaritet autogarkesë TVSH në shitje të bëra gjatë muajit dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 19 të Deklaratës tuaj. Këtu transaksione autogarkohen me 20% TVSH në shitje.

20. Nga kolona "n" e librit të shitjeve "TVSH e autogarkuar në shitje", nxirri totalin e TVSH-së për transaksionet për të cilat llogaritet autogarkesë TVSH në shitje për muajin dhe shumën e përftuar vendoseni në kutinë 20 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 20 duhet të jetë e barabartë me 20% të vlerës së paraqitur në kutinë 19.

21. Nga kolona "nj" e librit të shitjeve "Vlera e Tatueshme për veprime të Borxhit e keq" nxirri totalin për muajin të transaksioneve sipas nenit 84 të Ligjit, dhe vendoseni në kutinë 21 të Deklaratës tuaj. Shkalla e zbatueshme e TVSH-së është 20% (vlera +/-)

22. Nga kolona "o" e librit të shitjeve "TVSH për veprime të Borxhit e keq", nxirri totalin e TVSH-së për arkëtimet e Borxhit të keq për muajin me shkallë dhe shumën e përftuar vendoseni në kutinë 22 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 22 duhet të jetë e barabartë me 20% të vlerës së paraqitur në kutinë 21. (vlera +/-)

23. Llogarisi totalin e TVSH së mbledhshme për muajin, duke mbledhur TVSH e llogaritur për Shitje të tatueshme me 20% (kutia 14); Shitje të tatueshme me 6% (kutia 16); TVSH e llogaritur për shitje të tatueshme sipas regjimeve të agjentit udhëtimit/marzhit fitimit/ shitje në ankand, me 20% (kutia 18); TVSH e llogaritur për transaksionet e blerjes se shërbimeve nga persona jo rezident e autogarkuar në shitje me 20% (kutia 20), TVSH e mbledhshme nga veprime të Borxhit të keq me shkallë 20% (kutia 22). Shumën plotësojeni në kutinë 23. (vlera +/-)

### TVSH e zbritshme gjatë Muajit

24. Nga kolona "e" e librit tuaj të Blerjeve "Blerje të përjashtuara, me TVSH jo të zbritshme dhe pa tvsh", nxirri totalin e këtyre blerjeve dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 24 të Deklaratës tuaj. Këtu do të regjistrohen blerjet e përjashtuara, me TVSH jo të zbritshme dhe pa tvsh, përveç blerjeve të tilla të kryera për investime të cilat regjistrohen veçmas në kutinë 25. Për blerjet me TVSH jo të zbritshme nuk do të bëhet zbritje e TVSH.

25. Nga kolona "f" e librit tuaj të Blerjeve "Blerje investime brenda vendit pa TVSH", Këtu regjistrohen vetëm blerjet e kryera për qëllime investimi në pasurinë e subjektit të kryera brenda vendit dhe pa tvsh si p.sh. blerjet e përjashtuara, me TVSH jo të zbritshme dhe pa tvsh, për investime. Nxirri totalin e këtyre blerjeve dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 25 të Deklaratës tuaj.

26. Nga kolona "g" e librit tuaj të Blerjeve "Importe të përjashtuara të investimit pa TVSH", nxirri totalin e importeve dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 26 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen vetëm importet e kryera për qëllime investimi në pasurinë e subjektit.

27. Nga kolona "gj" e librit tuaj të Blerjeve "Import mallra të përjashtuara", nxirri totalin e

importeve dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 27 të Deklaratës tuaj. Këtu do të regjistrohen të gjitha importet e mallrave të përjashtuara nga TVSH, përveç importeve të përjashtuara për investime të cilat regjistrohen veçmas në kutinë 26.

28. Nga kolona "h" -"Vlera e Tatueshme e Importe mallra me shkallë 20%" e librit tuaj të Blerjeve, për muajin, nxirri totalin e vlerës së tatueshme të importeve të mallrave me shkallë 20% dhe plotësoni shumën e përftuar, në kutinë 28 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen vetëm importet e mallrave me shkallë 20%, përveç atyre të kryera për qëllime investimi në pasurinë e subjektit, të cilat deklarohen në kutinë 30.

29. Nga kolona "i" -"TVSH në Import për mallra me shkallë 20%" e librit tuaj të Blerjeve, nxirri totalin e TVSH-së në import për mallrat jo të investimit dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 29 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 29 duhet të jetë e barabartë me 20% të vlerës së kutisë 28.

30. Nga kolona "j" -"Vlera e Tatueshme e Importe investimi me shkallë 20%" e librit tuaj të Blerjeve, për muajin, nxirri totalin e vlerës së tatueshme të importit me shkallë 20% dhe plotësoni shumën e përftuar, në kutinë 30 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen vetëm importet e mallrave me shkallë 20% të kryera për qëllime investimi në pasurinë e subjektit, të cilat deklarohen në kutinë 30.

31. Nga kolona "k" -"TVSH në Import për investimi me shkallë 20%" e librit tuaj të Blerjeve, nxirri totalin e TVSH-së në import për mallrat jo të investimit dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 31 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 31 duhet të jetë e barabartë me 20% të vlerës së kutisë 30.

32. Nga kolona "l" -"Vlera e tatueshme nga furnitorë vendas me shkallë 20%" e librit tuaj të Blerjeve, nxirri totalin e këtyre blerjeve dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 32 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen të gjitha blerjet brenda vendit përveç atyre të kryera për qëllime investimi në pasurinë e subjektit që deklarohen në kutinë 34. (vlera +/-)

33. Nga kolona "ll" -"TVSH për blerje nga furnitorë vendas me shkallë 20%" e librit tuaj të Blerjeve, mbledhni totalin e këtyre blerjeve dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 33 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 33 duhet të jetë e barabartë me 20% të vlerës së kutisë 32. (vlera +/-)

34. Nga kolona "m" -"Vlera e tatueshme për blerje të investimit nga furnitorë vendas me shkallë 20%" e librit tuaj të Blerjeve, nxirri totalin e këtyre blerjeve dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 34 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen vetëm blerjet brenda vendit të kryera për qëllime investimi në pasurinë e subjektit. (vlera +/-)

35. Nga kolona "n" -"TVSH për blerje të investimit nga furnitorë vendas me shkallë 20%" e librit tuaj të Blerjeve, mbledhni totalin e këtyre blerjeve dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 35 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 35 duhet të jetë e barabartë me 20% të vlerës së kutisë 34. (vlera +/-)

36. Nga kolona "nj" -"Vlera e tatueshme e Blerjeve nga fermerët vendas" e librit tuaj të Blerjeve, nxirri totalin e këtyre blerjeve nga fermerët e identifikuar me NIPT por jo të regjistruar për TVSH-në dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 36 të Deklaratës tuaj. Shkalla e zbatuar nga blerësi për këto blerje është 20%.

37. Nga kolona "o" -"TVSH i zbritshëm, kompensimi i fermerëve" e librit tuaj të Blerjeve, mbledhni totalin e këtyre blerjeve dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 37 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 37 duhet të jetë e barabartë me 20% të vlerës së kutisë 36.

38. Nga kolona "p" e librit të blerjeve "Vlera e Tatueshme për Autogarkesë TVSH në blerje" nxirri totalin për transaksionet e blerjes së shërbimeve nga persona jo rezident në Shqipëri për të cilat llogaritet autogarkesë TVSH në shitje, të bëra gjatë muajit dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 38 të Deklaratës tuaj. Shkalla e TVSH-se e zbatuar është 20%.

39. Nga kolona "q" e librit të blerjeve "TVSH e autogarkuar në blerje", nxirri totalin e tvsh-së për muajin të transaksioneve për të cilat llogaritet autogarkesë TVSH në blerje dhe shumën e përftuar vendoseni në kutinë 39 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 39 duhet të jetë e barabartë me 20% të vlerës së paraqitur në kutinë 38.

40. Nga kolona "r" e librit të blerjeve "Vlera e Tatueshme për Rregullim të TVSH së zbritshme" nxirri totalin për rregullimet e TVSH-së të kryera gjatë muajit, sipas nenëve 78-83 dhe 73 pika 3 të Ligjit, dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 40 të Deklaratës tuaj. Shkalla e TVSH-së e zbatuar është 20%. (vlera +/-)

41. Nga kolona "rr" e librit të blerjeve "TVSH e Rregulluar", nxirri totalin e tvsh-së për rregullimet të TVSH për muajin dhe shumën e përftuar vendoseni në kutinë 41 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 41 duhet të jetë e barabartë me 20% të vlerës së paraqitur në kutinë 40. (vlera +/-)

42. Nga kolona "s" e librit të blerjeve "Vlera e Tatueshme të Borxhit e keq" nxirri totalin e vlerave të transaksioneve të borxhit të keq dhe regjistrojeni në kutinë 42 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen transaksione të borxhit të keq me shkallë 20% të TVSH-së. (vlera +/-)

43. Nga kolona "sh" e librit të blerjeve "TVSH për veprime të Borxhit e keq", nxirri totalin e tvsh-së për faturimet e Borxhit të keq për muajin me shkallë dhe shumën e përftuar vendoseni në kutinë 43 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 43 duhet të jetë e barabartë me 20% të vlerës së paraqitur në kutinë 42. (vlera +/-)

44. Llogarisi totalin e TVSH së zbritshme për muajin, duke mbledhur TVSH e zbritshme për Importet mallra me shkallë 20% (kutia 29); TVSH e zbritshme për Importet të investimeve me shkallë 20% (kutia 31); TVSH e zbritshme për Blerjet nga furnizuesit vendas me shkallë 20% (kutia 33); TVSH e zbritshme për Blerjet për investime nga furnizuesit vendas me shkallë 20% (kutia 35); TVSH (kompensimi) i paguar për blerjet nga fermerët (kutia 37); TVSH e llogaritur për transaksionet e blerjes se shërbimeve nga persona jo rezident e autogarkuar në blerje me 20% (kutia 39); TVSH e rregulluar shkallë 20% sipas kutisë (41) TVSH e zbritshme nga veprime të Borxhit të keq me shkallë 20% (kutia 43). Shumën plotësojeni në kutinë 44. (vlera +/-)

### Rezultati i TVSH për muajin

45. Në kutinë 45 të Deklaratës llogaritet **Tepricë e TVSH së zbritshme për muajin**, zbritur vlerën e kutisë 23 nga vlera e kutisë 44, nqs totali i TVSH të zbritshme për muajin (kutia 44) është më i madh se TVSH i llogaritur për shitje e muajit të paraqitura në kutinë 23. Pra keni si rezultat **Tepricë të TVSH së zbritshme për muajin** dhe nuk duhet të bëni pagesë TVSH në këtë muaj.

46. Në kutinë 46 të Deklaratës llogaritet TVSH e detyrueshëm për tu paguar duke zbritur vlerën e kutisë 23 nga vlera e kutisë 44, nqs shuma e TVSH-së së llogaritur për muajin me shkallë tatimore 20%, në kutinë 23 të deklarates është më i madh se totali i TVSH të zbritshme për muajin (kutia 44), pra keni rezultat me **TVSH të detyrueshme për tu paguar**.

### Shënime : Mbi plotësimin e Deklaratës së TVSH-së

Kjo deklarata është konceptuar në bazë të Ligjit Nr. 92/2014 datë 24.07.2014 "Për TVSH-në në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar dhe është përshatshme për të kryer deklarimin e TVSH-së sipas mënyrës të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore. Deklarata duhet të plotësohet dhe deklarimet në mënyrë elektronike brenda datës 14 të muajit pasardhës të muajit të reguar në Deklaratë, si periudhë tatimore. Udhëzimet dhe procedurat automatizohet nga sistemi pasi të keni plotësuar dhe dërguar këtë deklarata. Nqs ju keni pagesë për të bërë dhe e bëni këtë pagesë të plotë brenda afatit nuk ju aplikohen kamatavonesa ose gjoja për mospagesë në afat të vlerës së pagesës. Nqs bëhet një pagesë e pjeshme ose një pagesë e vonuar, detyrimin tuaj sipas kutisë 44 të kësaj deklarate i shihen gjojat dhe interesat përfitues nga data që detyrimi duhet paguar deri në datën kur kryhet pagesa. Vendosni datën e plotësimit të Deklaratës, dhe dërgojni deklarata në mënyrë elektronike, ku një kopje e kësaj deklarate do t'ju ruhet në llogarinë tuaj si tatimpagues, më shumë informacion lexoni aktet ligjore dhe nënligjore për TVSH-në. (Ligjin dhe Udhëzimin e TVSH-së etj) ose merrni kontakt me Drejtorinë Rajonale Tatimore ku jeni i regjistruar.



**Libri i Shitjeve**

Shoqëria Emri i Shoqërisë  
 Nipiti Nipiti i Shoqërisë  
 Viti Viti për të cilin plotësohet libri (yyyy)  
 Muaji Muaji për të cilin plotësohet libri - muaji nga 01 deri 02

Fa veprimtari  Plotëso PD nese gjate muajitruk edhte bere asnje transakcion.

Fatura			Bleresi			Totali Shitjeve	Shitjet e perjashtuar a	Shitjet pa TVSH	Eksporte mallrash	Furnizime me 0%	Shitje me shkalle 20%		Shitje me shkalle 6%		Shitje regjimi agjenteve te udhetimit/ marzhi fitimit / shitje ne zekand		Autangarlese TVSH ne shitje		Borxh i leq	
Nr Fatures	Numri Serial	Data (dd/mm/yyyy)	Emri i tregtar /personi	Rrethi	NIPT						Vlera e Tateshme	Tvsh	Vlera e Tateshme	Tvsh	Vlera e Tateshme	Tvsh	Vlera e Tateshme	Tvsh	Vlera e Tateshme	Tvsh
a	b	c	q	d	dh	$a \times (b + c) + b \times d + c \times d + d \times h$	e	f	g	gj	h	i = (h) x 20%	j	k = (j) x 6%	l	l = (l) x 20%	m	n = (m) x 20%	o	o = (o) x 20%
						0.00					0	0	0.00	0	0	0	0	0	0	0
						0					0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
						0					0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
						0					0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
						0					0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
						0					0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
						0					0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
						0					0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
						0					0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
						0					0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Shuma totale</b>						<b>0.00</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0.00</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
Kutia sipas formularit te Deklarimit dhe Pageses se TVSH-se							kutia (9)	kutia (10)	kutia (11)	kutia (12)	kutia (13)	kutia (14)	kutia (15)	kutia (16)	kutia (17)	kutia (18)	kutia (19)	kutia (20)	kutia (21)	kutia (22)

Emri Mbiemri

Shpjegim:  
 Ne rastin kur ky liber do te printohet, perqelime te ruajtjes/ mbajtjes se dokumentacionit, cdo faqe e printuar duhet te ketë ne krye pemblajtjen / mreshtat nga 1 ne 12.  
 Nr i mreshtave mund te shtohet ne perputhje me nre transakcioneve

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2017

Adresa:  
Bulevardi “Gjergj Fishta”  
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”

Çmimi 56 lekë